



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 38

Tiranë – E enjte, 11 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 5.3.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 73, datë 5.2.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021” 4787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 10.3.2021	Për shfuqizimin e vendimit nr. 62, datë 29.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese” 4787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 10.3.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje” 4788



VENDIM
Nr. 135, datë 5.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 73, DATË 5.2.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 1 dhe 2, të vendimit nr.73, datë 5.2.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi prej 1 457 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, i cili detajohet, si më poshtë vijon:

a) 931 000 000 (nëntëqind e tridhjetë e një milionë) lekë në zërin “shpenzime korrente”.

b) 526 000 000 (pesëqind e njëzet e gjashtë milionë) lekë në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet:

a) Në masën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, nga fondi rezervë për zgjedhjet, miratuar për vitin 2021;

b) Në masën 457 000 000 (katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2021.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 147, datë 10.3.2021

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 62, DATË 29.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE ÇAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 62, datë 29.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe çaktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 153, datë 10.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 8, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË
PËRFITIMIT TË SIPËRFAQEVE
NDËRTIMORE NË OBJEKTET E REJA
PËR BANIM NGA SUBJEKTET QË
POSEDOJNË NDËRTIME TË
KLASIFIKUARA SI NDËRTIME
PA LEJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8, e vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Sipërfaqja ndërtimore në objektet e reja për banim, që përfitojnë poseduesit e ndërtimeve pa leje, është 100 për qind e sipërfaqes së objektit pa leje.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë zbatuese, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë